



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5167 Prot.
8

Pogradec, më 28 . 12 . 2021

VENDIM

Nr. 122 datë 24.12. 2021

**“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË RIINTEGRIMIT PËR VIKTIMAT E DHUNËS
NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1, shkronja (a) dhe (b), nenit 55, pikat 2 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Këshilli Bashkiak Pogradec në mbledhjen e tij të datës _____.2021 shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, pranë Bashkisë Pogradec, për miratim e : *Planit të Riintegritimit për Viktimat e Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore* i cili është një mjet i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Pogradec në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit, zbatimit të nevojave të të drejtave të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve dhe nga të gjitha grupet e shoqërisë i mbështetur në kuadër të Kartës Europiane për Barazi Gjinore të grave dhe burrave në jetën vendore nëshkruar nga Kryetari i Bashkisë Pogradec z. Ilir Xhakolli datë 28.05.2020; Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, Plani i Kujdesit Social Bashkia Pogradec 2019-2023.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Riintegritimit për Viktimat e Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë gjinore, sipas lidhjes bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale, pranë Bashkisë Pogradec
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotirag MANGËRI





**PLAN RIINTEGRIMI
PËR VIKTIMAT E DHUNËS NË FAMILJE DHE DHUNËS ME BAZË GJINORE**

BASHKIA POGRADEÇ
DREJTORIA E SHERBIMEVE SOCIALE
BASHKIA POGRADEÇ

NENTOR 2021



Plani i Veprimit për ri-integrimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave, viktimat të dhunës në familje dhe/ose viktimat të dhunës me bazë gjinore.

Hartimi i Planit të Veprimit për Ri-integrimit Socio-Ekonomik të grave dhe vajzave viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe/ose viktimat të dhunës në familje, u mbështet me asistencë teknike nga AWEN në kuadër të Projektit “Mbështetja e bashkive në analizimin dhe adaptimin e modeleve/skemave të reja për integrimin socio – ekonomik për viktimat e DHBGJ –DHF”, pjesë e Programit të Përbashkët të OKB-së “Fund Dhunës ndaj Grave”, financuar nga Qeveria Suedeze dhe zbatuar nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë. Plani u përgatit përmes një procesi të udhëhequr nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Pogradec, të mbështetur nga AWEN, ku u angazhuan specialistët e Sektorit të Shërbimeve Sociale dhe Barazisë Gjinore.

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e UN Women, Shqipëri.

Pogradec, 2021



Tabela e përmbajtjes

Falënderime	5
Hyrje	Error! Bookmark not defined.
Përkufizim i termave.....	8
Metodologjia	12
Programi afat-gjatë i riintegrit të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore është i ndarë në 3 faza.....	13
Faza e parë: Faza e tranzicionit - Akomodimi dhe asistenca paraprake (deri në 1 vit).....	13
Faza e dytë: Jetesa gjysmë e pavarur (6 muaj-12 muaj).....	13
Faza e tretë: Jetesë e pavarur (3 - 5 vjet).....	14
Shërbimet.....	15
Procesi i riintegrit.....	15
Referimi.....	15
Menaxhimi i rastit: Vlerësimi i nevojave, hartimi dhe zbatimi i planit të ndihmës nga profesionistët.....	16
Paraqitje e shkurtër e situatës në Bashkinë Pogradec dhe shërbimet që ofrohen	27
Tregues të suksesit dhe praktika të mira	40



Shkurtime

AZGKB	Aleana e Zgjeruar e Grave Këshilltare Bashkiake
AWEN	Rrjeti Shqiptar i Fuqizimit të Grave
DHKG	Dhuna kundër Grave
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DHF	Dhuna në familje
GTN	Grupi Teknik Ndër-sektorial
ETN	Ekipi Teknik Ndër-sektorial
KEDNJ	Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Gruas
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
RSH	Republika e Shqipërisë
SSHS	Shërbimi Social Shtetëror Rajonal
UN	United Nations (Kombet e Bashkuara)
UNICEF	United Nations Children's Fund (Fondi i Shteteve të Bashkuara për Fëmijët)
UNWOMEN	United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women (Entiteti i Kombeve të Bashkuara për Barazi Gjinore dhe Fuqizimin e Grave)
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve
PMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve
PVVBGJ	Punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve Plani Vendor i Veprimt për Barazinë Gjinor
PIM	Plani Individual i Mbrojtjes
UMM	Urdhër i Menjëherëshëm i Mbrojtjes
UPMM	Urdhri Paraprak i Mbrojtjes së Menjëhershme
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
UG	Shoqata "Unë, Gruaja"
ZVAP	Zyra Vendore Arsimore Pogradec



Falënderime

Ky plan është përgatitur nga Bashkia Pogradec, me pjesëmarrjen e strukturave të shërbimit social, dhe kontributin e OJF-ve që punojnë me viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Ekspertiza dhe asistenca teknike për përgatitjen e projektit është dhënë nga AWEN në kuadër të Projektit ‘Mbështetja e bashkive në analizimin dhe adaptimin e modeleve/skemave të reja për integrimin socio – ekonomik për viktimat e DHBGJ –DHF’, pjesë e Programit të Përbashkët të OKB-së “Fund Dhunës ndaj Grave, financuar nga Qeveria Suedeze dhe zbatuar nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në bashkëpunim me Qeverinë e Shqipërisë”. Për përgatitjen e planit punoi në një proces konsultimi me të gjithë aktorët, stafi i shoqatës “Unë, Gruaja”.

Një falënderim i veçantë shkon për stafin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Bashkia Pogradec si dhe Shoqatën “Unë, Gruaja” për kontributin e tyre të çmuar gjatë procesit të hartimit të këtij dokumenti.

Së fundmi, falënderime të veçanta dhe të përzemërta shkojnë edhe për përfituesit e shërbimeve, për besimin e tyre dhe kontributin që na kanë dhënë, duke ndarë përvojat e tyre personale apo duke dhënë rekomandime me qëllim përmirësimin e shërbimeve të ri-integritit dhe në funksion të procesit të qëndrueshëm të viktimave që i kanë mbijetuar dhunës.



Hyrje

Bashkia Pogradec ka aprovuar një plan vendor veprimi për barazinë gjinore për periudhën shtator 2020- shtator 2023, i përgatitur nga Bashkia në kuadër të zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi Gjinore të grave dhe burrave në jetën vendore.

Kryetari i Bashkisë Pogradec nënshkroi Kartën Evropiane në 9 Mars 2020, duke e bërë atë pjesë të dokumenteve dhe instrumenteve, të cilat orientojnë veprimet dhe hapat që ndërmerren në të gjitha aspektet e jetës politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore. Që nga nënshkrimi i këtij dokumenti të rëndësishëm, Bashkia dhe në mënyrë specifike Drejtoria e Shërbimeve Sociale është angazhuar maksimalisht për plotësimin e detyrimit për zbatimin e Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore në nivel vendor.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) është një mjet i rëndësishëm i zbatimit në praktikë të angazhimeve publike të ndërmarra nga Bashkia Pogradec në lidhje me parimet e barazisë, planifikimit dhe zbatimit të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe burrave, vajzave dhe djemve.

Në mbështetje të kuadrit ligjor ndërkombëtar e kombëtar, si dhe të prioriteteve kombëtare dhe vendore, Bashkia Pogradec ka bërë përpjekjet e saj ndër vite për hedhjen e hapave drejt avancimit në çështjet e fuqizimit të grave dhe arritjes së barazisë gjinore. Pozicioni i Nëpunësës / Nëpunësit të Barazisë Gjinore që plotëson njëkohësisht dhe funksionet e Koordinatorës / Koordinatorit Vendor kundër Dhunës në Familje është bërë prej vitesh pjesë e organogramës së bashkisë, ndërkohë që Bashkia Pogradec ka qenë ndër pesë bashkitë e para në vend që kanë ngritur Mekanizmin e Koordinuar të Referimit të rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, që në vitin 2008. Po kështu, Bashkia Pogradec është një nga bashkitë në vend që administron një strehëz emergjence për trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare.

Gjithashtu, në Planin e Mbrotjes Sociale 2019-2023 të Bashkisë Pogradec, është parashikuar ndër të tjera: ngritja e mekanizmave dhe kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social sipas nevojave në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec, ofrimi i shërbimeve lehtësuese dhe mbështetëse për gratë kryefamiljare, rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të grupeve të rrezikuara, etj.



PVBGJ 2020-2023 propozon masa e veprime, që synojnë adresimin e mëtejshëm të çështjeve të pabarazive e diskriminimit dhe që fokusohen në respektimin e të drejtës themelore të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, vajzave dhe djemve, aksesin në shërbime të ndryshme të hartuara sipas nevojave të veçanta të grave dhe burrave, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve me cilësi e në respektim të parimeve të barazisë, planifikimin e mbështetur në burimet e duhura, etj.

Në objektivin specifik 2.1 thuhet: Të ngrihen mekanizmat dhe kapacitetet e duhura për ofrimin e shërbimeve të kujdesit social sipas nevojave në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec dhe në objektivin 2.2 thuhet: Të rritet efektiviteti i qasjes shumësektoriale dhe shërbimeve bazë të specializuara për viktimat / të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

Përsa i përket buxhetimit të aktiviteteve të PVVBGJ, një pjesë të mirë të aktiviteteve Bashkia e mbulon përmes angazhimit të burimeve ekzistuese njerëzore e financiare (pra specialisteve / specialistëve, të cilat / cilët aktualisht marrin një page fikse, sallave / ambienteve që ka në pronësi për të zhvilluar aktivitete të ndryshme, apo vënien në dispozicion të makinës dhe materialeve kancelarike, të cilat blihen në total për të gjithë institucionin, etj.).

Përcaktimi i kostove për aktivitetet e propozuara është bërë duke mbajtur në konsideratë faktin nëse aktiviteti i propozuar është primar për këtë Plan Veprimi apo referohet si primar në një tjetër strategji / plan veprimi të përgatitur nga Bashkia Pogradec (dhe në këtë rast kostot e përcaktuara, së bashku me afatet kohore, mënyrën e zbatimit, etj., merren direkt siç janë parashikuar në atë dokument). Një pjesë e kostove janë përcaktuar gjithashtu duke u bazuar në buxhetin e Bashkisë Pogradec për vitin 2020, si dhe në parashikimin e bërë nga Bashkia Pogradec në 2020 - 2022. Po kështu, janë përdorur kostot referente të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2016 - 2020.

Në plan parashikohen aktivitete që adresojnë çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje, por nuk ka një zë të veçantë në këtë plan për shërbime dhe mbështetje për viktimat e dhunës në familje dhe mbështetja që ofrohet për këtë kategori është nga fondet e qeverisë.

Bashkia Pogradec përfiton nga Fondi Social, i cili vjen në total pa specifikime, detajime dhe kjo shpërndahet nga sektori i ndihmës ekonomike sipas nevojës.



Përkufizimi i termave

Strehëz, përfshin një vend ku mund të jetohet për një periudhë afatshkurtër në përgjigje të një krize të menjëhershme të dhunës në familje, qoftë kjo në një qendër (strehëz), ose një shtëpi e sigurt ku viktimat e dhunës mund të qëndrojnë për një kohë të shkurtër.

Këshillim, të biseduarit me një person nga programi i dhunës në familje (këshillues) rreth eksperiencës të të qenit e dhunuar dhe impakti i saj tek viktimat e dhunës dhe/ose fëmijët e saj, duke përfshirë ndjenjat dhe zgjedhjet e tyre, si dhe zhvillimi i mënyrave për të përmirësuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre. Viktimat e dhunës zakonisht takohen me një këshillues më vete, ose në praninë e një anëtarit të familjes së tyre. Takimet zakonisht caktohen paraprakisht dhe mund të organizohen çdo javë, muaj ose edhe më gjatë.

Mbështetje psikologjike, është mbështetja e cila ofrohet nga persona specialistë si: psikologë, punonjës socialë, terapistë, etj. Këta specialistë ofrojnë shërbimin për persona të cilët përballen me vështirësi apo problematika të gjëndjes së tyre psikologjike apo emocionale.

Mbështetje ligjore, ndihmë ose mbështetje lidhur me çështje penale ose civile. Shembuj të saj përfshijnë ndihmën për të marrë Urdhërin e Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) ose Urdhërin e Mbrojtjes (UM), ose për çështje lidhur me arrestet, divorcin, kujdestarinë e fëmijës dhe vizitave tek ata, si dhe çështje të tjera që përfshijnë sistemin gjyqësor.

Shërbime të përkujdesit shoqëror, sipas Ligjit nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RPSH”, është një sistem i integruar dhe i organizuar përfitimesh dhe lehtësish, të cilat ofrohen nga profesionistë të fushave përkatëse të subjekteve publike ose jopublike, me qëllim sigurimin e mirëqenies, pavarësisë dhe përfshirjes shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. Sipas nenit 5 të këtij ligji, të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror e kanë individë ose familje, që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t’i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe të gjithë individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale.

Shërbime rezidenciale, janë shërbime të kujdesit 24 (njëzet e katër) orësh dhe afatgjatë për



individë në nevojë (fëmijë ose të rritur), të ofruara në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike. (Ligji 121/2016, neni 3).

Shërbime të specializuara

Në qytetin e Pogradecit ofrohen disa shërbime dhe burimet ekzistuese për trajtimin afatshkurtër dhe afatgjatë të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- **Qendra Speciale** ofron shërbime nga profesionistë të profilizuar në specialitete të ndryshme. Këto shërbime ofrohen në nivel qarku/rajonat dhe bashkie për fëmijët me çrregullime pervazive të zhvillimit, prapambetje mendore, çrregullime në komunikim, në nevojë për aftësim fizik, fëmijët e abuzuar seksualisht, fëmijët në konflikt me ligjin, si dhe gratë e vajzat e abuzuara, të dhunuara, si dhe të gjitha kategoritë që kanë nevojë për shërbime të tilla. (Ligji 121/2016, neni 3)
- **Shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line nga UG**, është shërbimi i ofruar nëpërmjet linjës telefonike dhe mediave online për mbështetjen, këshillimin në situata krize dhe referimin e rasteve të dhunës në familje dhe mbrojtjes së fëmijëve, sipas protokollove të hartuara dhe të miratuara. (Ligji 121/2016, neni 3)
- **Shërbime të përkujdesit komunitar**, janë shërbime që ofrohen në qendra komunitare lokale ose në mjedise të tjera, si shërbimet e kujdesit ditor apo të zëvendësimit të përkohshëm të kujdestarit për të gjitha kategoritë e përfutuesve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror. (Ligji 121/2016, neni 3).

Ofrimi i shërbimeve nga burime të jashtme: Situata ku shërbimi nuk është siguruar nga një autoritet publik (direkt ose nëpërmjet një entiteti "në banesë"), por nga ofruesit e jashtëm.

Ofruesit jofitimprurës janë institucionet ose organizatat e krijuara për qëllime të prodhimit të të mirave dhe shërbimeve, statusi i të cilëve nuk u lejon atyre të jenë burim i të ardhurave, fitimit ose fitimeve të tjera financiare për njësitë që krijojnë, kontrollojnë ose financojnë ato.

Palët e interesuara për kujdesin social janë përdoruesit e shërbimit, kujdestarët, prindërit, qeveria, rregullatorët, menaxherët dhe praktikuesit që mund të shihen si "palë të interesuara" në ofrimin e shërbimeve të kujdesit social.



Sistemi i mbrojtjes sociale: është sistemi i ndërhyrjeve, programeve, sigurimeve, asistencës sociale dhe përfitimeve sociale që ofrohen nga strukturat qeveritare, shoqëria civile dhe aktorët e komunitetit në nivel lokal, rajonal ose kombëtar garantojnë mirëqenien dhe mbrojtjen e të gjithë anëtarëve të shoqërisë, sidomos për njerëzit dhe komunitetet sociale apo ekonomike të pafavorizuar.

KONCEPTE

“Dhunë” është çdo veprim ose mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik. (sipas ligjit 1669 dt. 18.02.2006).

“Dhunë në familje” është çdo akt dhune, i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, që ndodh brenda familjes ose njësisë shtëpiake, e ushtruar ndërmjet pjesëtarëve të familjes, të përcaktuar në pikën 7, të këtij neni, që janë ose kanë qenë në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën.

Llojet e dhunës

- dhuna fizike - përfshin përdorimin e madhësisë trupore dhe të forcës fizike
- dhuna ekonomike – përfshin vënien në varësi ekonomike
- dhuna seksuale – përfshin imponimin, detyrimin ose përpjekjen për të detyruar kontakt ose sjellje seksuale pa pëlqimin e personit
- dhuna në internet - mesazhe shqetësuese nëpërmjet mediave sociale
- abuzimi emocional – shkatërrimi i ndjenjës së vetëvlerësimit dhe/ose të vetëbesimit
- abuzimi psikologjik – përfshin shkaktimin e frikës nëpërmjet trembjes

“Viktimë” është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e sipërpërmendur.

“Dhunues” është personi që ushtron dhe/ose paditet përpara organeve kompetente për ushtrimin e dhunës në marrëdhëniet familjare.



“Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje” (MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje.

Çfarë është ri-integrimi i viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Përcaktimi i nivelit të ri-integrimit të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje varet nga lloji dhe intensiteti i dhunës që ata pësojnë, nga kushtet e mjedisit përreth si dhe niveli i rrezikut në jetën e viktimës ose të fëmijëve të saj.

Që një viktimë e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore të ri-integrohet kjo varet nga disa faktorë që janë: lloji dhe intensiteti i dhunës që ata pësojnë, kushtet e mjedisit përreth, si dhe niveli i rrezikut në jetën e viktimës ose të fëmijëve të saj. Duhet të theksojmë se jo të gjitha viktimat kalojnë nëpër të njëjtën përvojë dhune, disa përjetojnë vetëm dhunë psikologjike, të tjerët kurrë nuk drejtohen në polici ose në sistemin gjyqësor pasi kanë frikë dhe mungesë besimi, ndërsa të tjerët nuk mund të kontaktojnë kurrë punonjësit socialë ose institucionet kombëtare për shkak të kufizimeve shoqërore, që inkurajojnë gratë të heshtin dhe të pranojnë dhunën që ata durojnë. Vihet re se të mbijetuarit e dhunës kalojnë nëpër tre faza vijuese përpara se të arrijnë në fazën e ri-integrimit. Metoda e ri-integrimit do të ndryshojë në varësi të nivelit të kalimit të vështirësive në të cilën gratë dhe vajzat ndodhen. Ri-integrimi zakonisht fillon kur gratë dhe vajzat arrijnë fazën e tretë - (në momentin kur kërkohet mbrojtje në një rreth më të gjerë), ndërsa në fazën e parë dhe të dytë, ndërhyrja e jashtme nuk ekziston pasi asgjë nuk raportohet.

Metodologjia

Metodologjia për hartimin e Plan e ri- integrimit përfshin disa hapa:



1. Rishikimi i literaturës mbi legjislacionin e zbatueshëm shqiptar; raporte dhe udhëzime, manualët për integrimin e VDHF/VDHBGJ; analizat e mëparshme të boshllëqeve për standardet dhe praktikën; Strategjitë dhe Planet Kombëtare të Veprimit për të luftuar dhe parandaluar dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore etj.
2. Rishikimi i literaturës për mbledhjen dhe analizën e një sërë dokumentesh, që janë identifikuar dhe kërkuar nga AWEN dhe që janë shtuar nga draftueset të këtij plani;
3. Identifikimi i aktorëve lokal dhe rolit të tyre në integrimin socio-ekonomik të grave dhe vajzave VDHBGJ dhe DHF ;
4. Krijimi i grupit të punës me përfaqësues të Bashkisë Pogradec, Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe organizimi i takimeve periodike përgjatë tërë procesit të hartimit të planit;
5. Konsultimi i draft planit me aktorë të tjerë relevantë për marrjen e sugjerimeve dhe rekomandimeve ;
6. Vlefshmëria e draftit final të planit.

Programi afatgjatë i riintegrit të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore është i ndarë në 3 faza:



Faza e parë: Faza e tranzicionit - Akomodimi dhe asistenca paraprake (deri në 1 vit)

Në qytetin e Pogradecit akomodimi i viktimave të dhunës bëhet deri 72 orë në qendrën e emergjencës. Në këtë qendër ofrohet vetëm akomodimi dhe fjetja në tre dhoma të përshtatura për viktimat e dhunës në familje pa pasur një staf të dedikuar. Shërbimi psikologjik dhe juridik për rastet e dhunës ofrohet falas nga Shoqata "Unë, Gruaja". Problematikë për këtë qendër është fakti se nuk ka personel që t'i shërbejë viktimës dhe ajo qëndron e vetme në këto ambiente.

Sa i përket akomodimit të mëtijshëm nuk është se viktimat ka një zgjidhje, por orientohet që të kthehet në familjen e origjinës, nëse ka marrëdhënie pozitive me ta dhe ata e mbështesin. Në rastet kur viktimat e dhunës në familje e ka domosdoshmëri strehimin pasi është pajisur me UM mundësia e vetme është Strehëza Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, e cila ka kapacitete të limituara pranimit ose mundësia e strehimit në Organizata të Shoqërisë Civile, të cilat e ofrojnë këtë mundësi.

Faza e dytë: Jetesa gjysmë e pavarur (6 muaj - 12 muaj)

Ky shërbim është ofruar në disa raste nga institucionet përgjegjëse, por duhet theksuar se kjo varet nga fondi që vihet në dispozicion, gjithashtu jo të gjitha rastet që kanë nevojë për strehim mund t'u mundësohet kjo gjë, si rezultat i buxhetit të pamjaftueshëm të lënë në dispozicion. Ofrimi i strehimit në apartamente me qera për përfutueset, të cilat kanë filluar të bëjnë kalimin e rëndësishëm në jetën "normale" është shumë i pakët në Bashkinë Pogradec. Bashkia nuk ka banesa sociale, të cilat t'u ofrohen kategorive në nevojë. Bashkia ka mbështetur dhe ka dhënë shumë pak qera për rastet në nevojë apo fonde për rikonstruktion banesash.

Sa i përket monitorimit të rasteve, ato ndiqen dhe marrin shërbime nga një sërë institucioneve si: UG, Koordinator i Dhunës në Familje, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, etj. Ato orientohen apo referohen në institucionet që kanë nevojë.

Pjesa e pagesës së qerasë për rastet e dhunës mbulohet kryesisht nga OJF, të cilat në bazë të projekteve dhe kjo nuk jep siguri sepse nuk janë projekte afatgjata. E rëndësishme do ishte që ky shërbim të sigurohet nga Bashkia, qoftë kjo dhe për një numër sado të vogël të rasteve të DHBGJ dhe DHF.



Faza e tretë: Jetesë e pavarur (3 - 5 vjet)

Faza e fundit e programit arrihet kur përfituesja është e gatshme për të jetuar një jetë të pavarur. Mbështetja e dhënë për këto raste është që t'i fuqizojë ato dhe gradualisht të largohen nga programi. Kjo mbështetje konsiston në:

1. Ofrimin e asistencës riintegruese për familjen dhe komunitetin ku jetojnë përfituesit;
2. Dhënie e informacionit mbi burimet dhe shërbimet e disponueshme në komunitet, kontaktet e nevojshme dhe harta e shërbimeve;
3. Ofrimin e asistencë për përfitueset në forcimin e marrëdhënieve me institucionet e mbështetjes në komunitetet ku ato jetojnë;
4. Monitorimi dhe vazhdimësia.

Faza e fundit e programit arrihet kur përfituesja është e gatshme për të jetuar një jetë të pavarur. Mbështetja e dhënë për këto raste është që t'i fuqizojë ato dhe gradualisht të largohen nga programi. Lidhur me fazën e tretë duhet shprehur se mungon një trajtim më afatgjatë për Viktimat e Dhunës apo programe që të sigurojnë mbështetje dhe monitorim në një afat 3-5 vjet. Bashkia Pogradec nuk ka programe apo mbështetje konkrete, mungesa e pagesës së qerasë së banesës sjell vështirësi që rasti të krijojë pavarësi dhe të integrohet në komunitet. Sa i përket punësimit Zyra e Punës si anëtare e MR luan një rol të rëndësishëm me ofrimin e vendeve të punës apo kurseve profesionale, por shpesh gratë dhe vajzat hasin në vështirësi për të përfituar nga këto programe. Mungesa e një pune sipas kushteve të saj e bën të vështirë si për Zyrën ashtu dhe për viktimën. Sa i përket praktikave riintegruese, informimit dhe asistencës për përfitueset në forcimin e marrëdhënieve me institucionet e mbështetjes në komunitetet ku ato jetojnë ky informacion viktimave iu ofrohet nga UG, Kordinatori i Dhunës në Familje apo OJF të tjera që ushtrojnë aktivitetin në zonë. Përsa i përket monitorimit të rasteve duhet të përpunojmë plane pune se si do kryhet monitorimi dhe të përcaktohet personat përgjegjës, që duhet të ndjekin monitorimin e rasteve deri në arritjen e plotë të jetesës në mënyrë të pavarur nga vetë rasti si dhe krijimi i infrastrukturës së nevojshme.

Shërbimet: - Procesi i riintegrimit



Referimi

Rastet e dhunës, të cilat trajtohen në Bashkinë Pogradec, identifikohen bazuar në Procedurat Standarde për identifikimin dhe Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje, Protokollin e Menaxhimit të Rasteve si në kohë pandemie ose jo, miratuar në Këshillin Bashkiak, shtator 2020, dhe VKM Nr.334, datë 17.2.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij" (për viktimat e dhunës në familje/dhunës me bazë gjinore). Të mbijetuarat referohen për shërbime nga burime të ndryshme, si Policia, SHSSH rajonal, NJMF, organizata të ndryshme, institucione të tjera shtetërore, personat e kontaktit, anëtarë të komunitetit, vetë-referime, etj. Pas identifikimit vlerësohen nevojat dhe viktimës i ofrohet informacioni i duhur për nevojat e shfaqura dhe më pas zgjedh shërbimet që i nevojiten. Pas identifikimit dhe referimit për mbështetje, stafi i bashkisë, së bashku me menaxherin e rastit të organizatës ofron informacion mbi të drejtat, si edhe mbi shërbimet që ofron Bashkia dhe UG.

Gjithashtu NJMF-ja Pogradec kur ka viktimat të dhunës në familje që përfshihen dhe fëmijët, mbledh GTN sipas dinamikave të rastit. Ajo njihet aktoret e GTN-së me draft planin dhe nevojat emergjente, ndan detyrat dhe përgjegjësitë dhe secili aktor merr përsipër ofrimin e shërbimeve. NJMF ka për detyrë t'i njohë me nivelin e riskut si edhe me mënyrën e menaxhimit të rastit. NJMF-ja pas vendimeve të dala nga GTN-ja harton planin individual të Mbrojtjes (PIM) duke marrë masën e mbrojtjes dhe të mbikqyrjes të specializuar si masa më e mirë dhe e përshtatshme në lidhje me rastin. Pas intervistës përgatit listën e nevojave me afatet kohore të duhura, ndan detyrat me personat përgjegjës dhe ndjek të gjitha shërbimet që rasti merr. E gjithë kjo procedurë shpesh bëhet në bashkëpunim me ZBGJ. Këto viktimat me vullnetin e tyre të lirë, pranojnë ofrimin e shërbimeve dhe ndjekin realizimin e të drejtave të tyre për atë që Bashkia ofron.

Menaxhimi i rastit: Vlerësimi i nevojave, hartimi dhe zbatimi i planit të ndihmës nga profesionistët



Pas identifikimit të rastit bazuar në nevojat që viktimat shfaq Koordinatori i Dhunës në Familje në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të MR harton planin e ndërhyrjes. Grupi multidisiplinar i qendrës/organizatës: punonjësit social, mjeku, psikologu, avokati, mësuesi, specialisti i fuqizimit ekonomik duhet të kryejnë vlerësimin e të gjitha nevojave të përfituesve brenda 2 javëve të para të përfshirjes në plan, të tilla si: nevoja për strehim, për mbështetje psiko-sociale, asistencë mjekësore dhe ligjore, ndërmjetësim me familjen, përgatitje profesionale, ndërmjetësim për punësim dhe përfshirje arsimore.

Për rastet emergjente mblidhet ETN dhe diskutohet për nevojat që rasti ka dhe çfarë i ofron secili institucion me qëllim riintegrimin. Sërisht problematik ngelet akomodimi pasi Bashkia Pogradec ka vetëm Qendrën e Emergjencës 72 orë dhe nuk ofron akomodim afatgjatë.

Për Bashkinë Pogradec bazuar në identifikimin e nevojave, punonjësit socialë (menaxherët e rasteve) në bashkëpunim me përfituesen, hartojnë një plan ndihme me objektiva specifike dhe periudha kohore të përcaktuara, aktivitete, burime të nevojshme njerëzore dhe financiare, si dhe realizohet ndërhyrja profesionale sipas objektivave të vendosura. Plani individual i ndihmës ka në përmbajtje: sigurinë, ndihmën shëndetësore, psikologjike, ligjore, arsimore, profesionale, ndihmën për punësim, mbështetjen familjare dhe të fëmijëve, planifikimin për akomodimin afatgjatë dhe vazhdimësinë.

Realizimi i të gjitha aktiviteteve mbështetëse bëhet në bashkëpunim me institucionet lokale, shtetërore dhe joshetërore, të cilat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve në komunitet, siç janë:

-Bashkia (Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale dhe Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve),

- Shërbimi Social Shtetëror Rajonal,

-Institucionet e shëndetit (fizik dhe mendor). Shërbimi i shëndetit mendor ofrohet në nivel Rajonal dhe është shumë e vështirë për t'u përfituar nga rastet në qytetin e Pogradecit, ku kemi vetëm një mjek psikiatër dhe trajtimet duhet të bëhen në qendrën rajonale të shëndetit mendor Korçë apo në Tiranë. Psh. kur kemi një vendim gjykatë me mjekim të detyruar për dhunuesin apo ndjekjen e programeve të të alkoolizuarve apo narkomaneve ky shërbim është i munguar në Pogradec.



-Institucionet arsimore,

-Institucionet e formimit profesional dhe Drejtoritë e Punësimit,

-Institucionet e zbatimit të ligjit si: Policia, Prokuroria, Gjykata, Përmbartimi, etj.

-Gjithashtu bashkëpunimi me OJF, të cilat operojnë në nivel lokal e kombëtar, të cilat mund të ofrojnë shërbime dhe ekspertiza të specializuara.

Menaxheri i rastit përpilon raporte progresi çdo dy muaj për përfitueset e programit, si edhe fton grupin multidisiplinar për të ridiskutuar dhe modifikuar (kur është e nevojshme) planin e ndihmës, në përputhje me progresin e regjistruar. Kjo e gjitha mbështetur në ligjin 9669 dt. 18.12.2006 "Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare".

Në qytetin e Pogradecit shërbimi i akomodimit dhe asistencë paraprake për përfitueset ofrohet vetëm në Qendrën e Emergjencës për 72 orë, por nuk ofrohet strehim afatgjatë në qendër riintegrimi apo në komunitet (apartamente me qera). Viktimat e dhunës, nënat e reja dhe fëmijët e tyre qëndrojnë falas në Qendrën e Emergjencës për 72 orë. Gjatë qëndrimit të tyre në Qendrën e Emergjencës, të mbijetuarave duhet t'iu ofrohet: kujdes mjekësor i përgjithshëm, arsimim, ndërtimi i shprehive për jetën, forcimi i marrëdhënieve familjare, mbështetje multidisiplinare për fëmijët e tyre, përgatitja e tyre profesionale, ndërmjetësimi për punësim dhe punësimi të paktën për një periudhë prej 2-3 muajsh, përpara se të kalojnë në fazën e riintegrit, atë të jetesës së monitoruar në komunitet. Asistencë psikologjike, ligjore momentalisht për gratë dhe vajzat viktimat të dhunës në familje ofrohet nga Shoqata "Unë, Gruaja".

Sa i përket NJMF Pogradec në rastet kur kemi fëmijë të pastrehë, të neglizhuar, fëmijë të braktisur ose të gjendur në situata të pasigurta dhe të vështira, mungesa e një qendre emergjente dhe e një personeli të specializuar për t'i ofruar asistencë fëmijëve në këto situata është problem me të cilin jemi ndeshur shpesh dhe jemi detyruar të kërkojmë asistencë nga Shërbimi Social ose OJF të cilat ushtrojnë aktivitetin në Qark.

Strehim në apartamente me qera / Jetesë gjysmë e pavarur

Aktualisht Bashkia Pogradec sa i përket strehimit në apartamente me qera dhe sigurimit të jetesës gjysmë të pavarur e ka shërbim të munguar. Viktimat e dhunës në këto kanë si zgjidhje të vetme të kthehen në familjen e origjinës.



Strehimi në apartamente me qera dhe sigurimit të jetesës gjysmë të pavarur, pagesa e qerasë së apartamentit (nga 6-12 muaj), janë alternativa si për fazën e parë ashtu edhe për fazën e dytë të riintegritit drejt jetesës së pavarur, për ato përfituese, që do të vlerësohen për të jetuar në komunitet dhe jo në familjen e origjinës.

Për të gjitha ato përfituese, të cilat nuk kanë zgjidhje dhe nuk mund të kthehen në familje për shkak të rrethanave të sigurisë apo mungesës së mbështetjes nga familja, duhet të vendosen në apartamente me qera të mbështetura nga programi për një periudhë 6-12 muaj. Ky shërbim duhet të jepet si për përfitueset dhe fëmijët e tyre, që ndodhen në fazën e parë të programit (të cilat kërkojnë të asistohen në komunitet), ashtu edhe për përfitueset, të cilët kanë marrë shërbimet në strehëz në fazën e parë të programit dhe vlerësohen për të kaluar në fazën e dytë. Gjatë kohës së qëndrimit në apartament rastet duhet të monitorohen nga grupi social dhe njëkohësisht të mbështeten për të gjitha nevojat që ato kanë. Gjithashtu Bashkia Pogradec strehimin e viktimave mund ta zgjidhë me Banesat Sociale në godina, të cilat i kanë kaluar apo i përkasin pronësisë së saj. Gjithashtu ndërtimi i godinave dhe banesavë sociale në trualle që ka pronësinë do ishte zgjidhje për këtë fazë të mbështetjes së përfituesëve të cilat e kanë si nevojë strehimin.

Sipas NJMF Pogradec nisur nga interesi më i lartë i fëmijës, në kuadër të deinstitutionalizimit të fëmijëve të pastrehë dhe planit për fuqizimin e familjes të punohet për ndërgjegjësimin në komunitet për familje pritëse dhe ato të origjinës që të mirëpresin këta fëmijë, pasi habitat i mirë për fëmijën është ambjenti familjar.

Asistencë dhe këshillim psikologjik

Shërbimi psikologjik për rastet e dhunës në Bashkinë Pogradec ofrohet falas nga Shoqata "Unë, Gruaja".

Psikologjia ofron asistencë dhe këshillim psikologjik për viktimat, ish-viktimat dhe fëmijët e tyre, në të gjitha fazat e programi. Psikologjia e ofron ndihmën nëpërmjet realizimit të seancave të këshillimit individual, këshillime dhe terapi në grup, fokus grupe me qëllim ndarjen e eksperiencave të tyre, trajtimin etj. Gjithashtu Pranë Bashkisë së fundmi struktura e tyre është plotësuar me një Psikologe që jep shërbimin për familjet në nevojë, viktimat e dhunës në familje, etj. Ky pozicion mbështetet në kuadër të projektit që Bashkia ka fituar nga Ministria e



Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi Forcimin e familjeve dhe çifteve të reja me shërbime sociale.

Që prej vilit 2017 Shoqata "Unë, Gruaja" ofron këtë shërbim falas për gra dhe vajza viktime të dhunës në familje si edhe mban kontakte me psikologët e shkollave. Rasti trajtohet që nga fillimi kur paraqitet për të kërkuar ndihmë dhe deri në arritjen e një stabiliteti psiko-emocional, ky shërbim ofrohet në një numër të caktuar seancash duke u bazuar nga nevoja dhe problematika që rasti shfaq.

Psikologjia e qendrës UG krahas këshillimit bën edhe përfaqësimin në gjykatë apo institucione të tjera për proceset e marrjes së UMM/ UM, proceset e divorcit, etj.

Gjithashtu psikologjia asiston të miturit në proceset gjyqësore, kur ata vetë janë pjesë e këtyre proceseve apo kur nënat e tyre ndjekin në gjykatë apo institucione të tjera procese dhe çështje të ndryshme.

Asistencë mjekësore

Për të patur sukses në procesin e trajtimit dhe riintegrit, për të gjitha viktimat e dhunës, duhet të sigurohen apartamente me qera, apo të referohen për t'u asistuar në familje (në zonat dhe komunitetet ku jetojnë). Të ofrohet mbështetja me asistencë mjekësore dhe konkretisht: vizita shëndetësore, ofrimi i medikamenteve, ekzaminime mjekësore etj. Po kështu viktimat duhet të asistohen dhe në drejtim të pajisjes së tyre me karta shëndeti, me qëllim përfitimin e mjekimeve të rimbursueshme nga shteti.

Në Bashkinë Pogradec, nëse rasti i dhunës ka fëmijë të mitur, ai në çdo intervistë, ose kontroll që kryhen fëmija tek Mjeku ligjor, ose Gjenekologu, Pediatri, apo çdo shërbim tjetër spitalor bëhet në prezencë të NJMF-së ose PMF-së pasi sipas ligjit 18/2017. I mituri nuk duhet të jetë i pa shoqëruar ose në prezencën e një Punonjësit Social (NJMF).

Asistencë mjekësore duhet të ofrohet nga mjeku ligjor dhe mjeku i familjes në bashkëpunim me institucionet shëndetësore. Duhet të kryhen të gjitha konsultat dhe analizat sipas rastit dhe dëshirës së përfituesve, kjo në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore e Kujdesit Shëndetësor Pogradec, i cili i ofron falas shërbime shëndetësore për target grupin e trajtuar.



me Qendrat Shëndetësore kryhet vaksinimi përkatës për fëmijët e përfitueseve të pa vaksinuar dhe vijohet rregullisht procesi i vaksinimit.

Përveç kontrolleve të vazhdueshme, mjeku ofron seanca këshillimi me përfitueset si dhe diskutime në grup në lidhje me: informimin e tyre për kujdesin e higjienës personale, sëmundjet seksualisht të trasmetueshme, kujdesi për fëmijët, pasojat e përdorimit të drogës, etj.

Në kuadër të këtij shërbimi bashkëpunohet edhe me OJF të tjera që ofrojnë shërbime shëndetësore falas, vizita gjinekologjike, paptest, teste shtatzanie, eko, seanca informimi, etj.

Asistencë ligjore.

Asistenca ligjore për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje në Bashkinë Pogradec ofrohet falas nga Shoqata "Unë, Gruaja". Kjo asistencë konsiston në drejtim të: informimit të viktimës në lidhje me legjislacionin në mbështetje dhe përmbushjen e të drejtave të tyre, sanksionet që ekzistojnë në ligj ndaj dhunuesve, ligjin për kompensimin, kujdestaria ligjore, etj. Avokatia e qendrës krahas këshillimit juridik bën edhe përfaqësimin në gjykatë për proceset e marrjes së UMM/ UM, proceset e divorcit etj. Së fundmi në qytetin e Pogradecit është hapur dhe Zyra e Shërbimit Ligjor Falas e cila garanton avokatë falas për këtë kategori dhe jo vetëm, gjithashtu avokatët e kësaj qendre ndjekin procese të ndryshme civile, penale, administrative, etj.

Nëpërmjet UG dhe Zyrës së Shërbimit Ligjor Falas ofrohet zgjidhja e problemeve civile dhe administrative, si pajisja me mjete identifikimi, mbështetja për hapjen e proceseve gjyqësore si me karakter civil ashtu edhe penal, si edhe ndjekja dhe përfaqësimi i tyre, regjistrimi i fëmijëve në gjendjen civile, gjyqet e divorcit, çështjet e kujdestarisë për fëmijët, etj, janë shërbime të tjera parësore, që ofrohen në kuadër të shërbimeve ligjore. Avokatia e UG dhe kjo zyrë ofrojnë këshillim dhe asistencë ligjore për të gjitha përfitueset, sipas nevojave të tyre. Gjithashtu avokatët shoqërojnë të gjitha viktimat dhe ish viktimat të cilat denoncojnë dhunuesit në institucionet e ligjit (prokurori, gjykatë, polici), në rolin e këshilluesit dhe përfaqësuesit ligjor.

Për rastet e fëmijëve që vijnë nga lidhje jashtëmartesore (fëmijë të prezumuar), ose të pa regjistruar pasi kanë ardhur në jetë në shtete të tjera, pra vijnë nga emigracioni, është zyra e NJMF ajo që ndjek hapat apo orjenton prindërit për procesin e regjistrimit të fëmijëve, duke



kërkuar mbështetje dhe nga shoqata "Unë, Gruaja", zyra ligjore falas në Tiranë (QNL, TLAS) që mundësojnë ofrimin e këtij shërbimi.

Mbështetje arsimore

Niveli arsimor viktimat e dhunës me bazë gjinore/në familje bazuar në statistikat dhe të dhënat e nxjerra nga rastet e asistuara, rezulton të jetë i larmishëm, por mbizotëron niveli i ulët arsimor. Kryesisht mbizotërojnë rastet e grave që kanë një nivel të ulët arsimor (9-vjeçare, gjimnaz). Kjo nuk do të thotë që nuk ka raste të grave me arsim të lartë, që përjetojnë situata dhune, por që nevoja për mbështetje shumë dimensionale është më e madhe në kategorinë e grave më pak të arsimuara, për shkak të varfësisë së tyre ekonomike që lidhet drejtpërdrejt edhe me nivelin e tyre arsimor. Shumë prej tyre, kryesisht në moshë të mitur, kanë ndërprerë shkollën ose janë martuar në moshë të vogël.

Për këtë arsye është parë e domosdoshme nxitja dhe mbështetja e përfitueseve për të vazhduar shkollën në sistemin me kohë të pjesshme apo edhe të plotë, por ende Bashkia Pogradec nuk ka projekt konkret përveç kurseve dhe nxitjes profesionale të këtyre grave. Nëpërmjet këtij shërbimi mbështeten të gjitha të mbijetuarat e dhunës, por edhe fëmijët e tyre. Sa i përket fëmijëve ky shërbim mundësohet nga Zyra Vendore Arsimore Pogradec ku vijnë përfitueset dhe fëmijët e tyre, apo në ato qarqe ku ato vendosin të jetojnë, gjithashtu Njësia e shërbimit psikosocial në ZVAP ka vënë në dispozicion 7 psikologë dhe 5 punonjës socialë të cilët ofrojnë asistencë psikologjike për gratë, vajzat dhe fëmijët.

Gjithashtu zyra e NJMF-së është në kontakt të vazhdueshëm me institucionet arsimore. Pika e tyre e parë e kontaktit janë psikologët e shkollave dhe drejtuesit e tyre të cilët refetojnë pranë NJMF çdo problematikë të nxënësve, problematika për të cilat ju duhet ndërhyrja e NJMF, siç është monitorimi dhe kthimi në rrugën e arsimit për nxënësit që nuk e frekuentojnë rregullisht shkollën apo që e braktisin atë.

Bashkëpunimi me këto institucione arsimore realizohet jo vetëm në kuadër të programit të riintegritit dhe detyrimit ligjor për sistemin e detyrueshëm arsimor, por gjithashtu dhe në zbatim të projekteve të sensibilizimit dhe ndërgjegjësimi të të rinjve në lidhje me rëndësinë e arsimit dhe fuqizimin e të rinjve, etj.

Mbështetje dhe këshillim në familje



Vendosja e kontakteve me familjen si dhe bashkimi i përfitueseve me familjarët është prioritet, duke e vlerësuar shumë të rëndësishëm për një riintegrim të suksesshëm të viktimave. Në këtë kuadër, punonjësit socialë lehtësojnë vendosjen e kontakteve me familjarët, si edhe ndërmjetësojnë forcimin e marrëdhënieve familjare. Kjo realizohet nëpërmjet vizitave të vazhdueshme në familje, informimit dhe këshillimit të anëtarëve të familjes.

Të gjitha rastet e fëmijëve në nevojë janë në monitorim të vazhdueshëm dhe koherent nga NJMF dhe PMF. Aktoret e GTN-së ku përfshihen dhe OJF-të, janë ndihmë shumë e madhe edhe në procesin e fuqizimit të familjes për krijimin e një ambjenti sa më të ngrohtë familjar me të gjithë komponentet që e përbëjnë atë ndijmojnë për interesin më të lartë të fëmijëve.

Duke qenë se programi ka një aspekt fuqizues të familjes, synohet që të ofrohet mbështetje multidisiplinare edhe për anëtarë të tjerë të familjes, kryesisht nëpërmjet këshillimeve, mentorimeve, ndërmjetësimeve drejt shërbimeve komunitare, ose në rast të përfitueseve minorene, të cilat në planin e tyre afatgjatë kanë kthimin pranë familjeve, bëhet një plan në fazën e dytë dhe të tretë të programit për mbështetje në familje, me ndërmjetësim për punësim, rritje profesionale të anëtarëve të familjes, ose ofrimin e mikrobizneseve, në rast se ky proces ka qëndrueshmëri.

Mbështetje për fëmijët e viktimave

Sa i përket viktimave të DHBGJ dhe DHF shoqata UG ofron këshillim psikologjik për gratë dhe vajzat e dhunuara gjithashtu dhe për fëmijët e tyre. Psikologjia e UG mban kontakte të rregullta me përfaqësuesit e ZBGJ, NJMF, psikologët e shkollave, etj.

Zyra e NJMF-së është në kontakt të vazhdueshëm me të gjithë aktorët që mund të referojnë problematika të fëmijëve me nevoja të ndryshme si psikologët e shkollave, ZBGJ, oficeri i sigurisë në shkolla, etj. Gjithashtu monitoron të gjitha rastet hap pas hapi për sigurinë, mirëqenien dhe për interesin më të lartë që janë fëmijët dhe gjithë situata të jetë në funksion të këtij interesi. Ndjek sipas ligjit 18/2017 hap pas hapi të gjithë procesin deri sa rasti të ketë marrë rrugën e zgjidhjes dhe përpilon dosjen me të gjitha dokumentacionet e duhura për çdo rast.



Për të gjithë fëmijët e rasteve të mbështetura të cilët trajtohen nga institucionet e MR së bashku me nënat e tyre, ofrohet një paketë e plotë shërbimesh në përputhje me nevojat e identifikuar, ashtu si edhe për vetë përfitueset. Këto shërbime konsistojnë në: arsimim, kujdes shëndetësor dhe psikologjik, mbështetje ligjore (në rastet kur nevojitet, psh. regjistrim në gjendjen civile, kujdestari, etj), regjistrim dhe mbështetje në procesin arsimor në çerdhe, kopësht, shkollë, etj.

Aktivite për fuqizimin ekonomik

Trajnimi për punësim. Në Pogradec janë dy shkolla "Amarotan" dhe "Enver Qiraxhi" që ofrojnë falas kurse të ndryshme për formim profesional si psh kuzhinë, trobaqepsi, etj. Gjithashtu dhe Bashkia Pogradec ka një projekt mbi aftësimin profesional dhe kurset profesionale për përgatitjen e grave dhe vajzave të dhunuara për tregun e punës. Gjithashtu bazuar dhe në marrëveshje me Zyrën e Punësimit në Pogradec si anëtare e Mekanizmit të Referimit të Rasteve të Dhunës ka një bashkëpunim të mirë jo vetëm me UG, por dhe me institucione të tjera për të punësuar këtë target grup.

Ky aktivitet i ofruar nga Bashkia Pogradec në bashkëpunim me institucionet e tjera realizohet nëpërmjet përfshirjes së përfituesve në një cikël të plotë trajnimi: 1) të mësuarit e koncepteve bazë për t'iu afruar tregut të punës; 2) përfshirja në formimin profesional ose trajnimet në punë, pranë bizneseve; 3) punësimi pranë këtyre bizneseve, pas përfundimit të trajnimit në punë.

Zyra e punësimit luan një rol të rëndësishëm në këtë aspekt duke mbajtur një bashkëpunim me çdo institucion të MR që referon raste qofshin këto të mbijetuara të dhunës në familje apo shtresat vulnerabël duke i trajtuar me prioritet çdo rast që i referohet.

Zyra e NJMF Pogradec nisur dhe nga Ligji, i cili parashikon që fëmijët mbi moshën 16-vjeç mund të punësohen në punë sezonale gjatë sezonit veror apo orar të reduktuar, kjo në përputhje me moshën e tyre, ka një bashkëpunim me zyrën e punës për fëmijë të cilët janë të interesuar të punojnë.

Formim profesional dhe trajnim në punë.

Nëpërmjet ofrimit të kurseve profesionale synohet ofrimi i mundësive për t'u përgatitur profesionalisht me qëllim përfshirjen e ish viktimave në tregun e punës. Ky shërbim nuk ofrohet në Bashkinë Pogradec. Rastet referohen të ndjekin këto kurse nëse ata e shfaqin dëshirë pranë



shkollës Profesionale apo qendrës "Amarotan" apo ndonjë OJF tjetër e cila mund t'i ofrojë këto kurse në kuadër të projekteve, por në përfundim të kurseve grave dhe vajzave nuk iu ofrohet një punë e sigurt apo t'i dhurohen materialet e nevojshme bazë për të nisur ato vetë një punë dhe për të krijuar pavarësi dhe fuqizim ekonomik në një të ardhme.

Shërbimi i ndihmës për punësim.

Këto shërbime konsistojnë në orientimin dhe këshillimin për punësim, ndërmjetësim me punëdhënës të ndryshëm për punësim. Përfitueset e punësuar ose të vetëpunësuar kanë një status më të mirë ekonomik dhe janë më të qëndrueshme në procesin e rehabilitimit dhe riintegritimit në shoqëri. Ky shërbim realizohet nga UG dhe institucionet e tjera të MR në bashkëpunim dhe me Zyrën Vendore të Punësimit Pogradec, për gjetjen e mundësive për punësim për përfitueset si edhe përfshirjen në programet e nxitjes së punësimit.

Mbështetja me mikrobiznese.

Ky shërbim do të thotë që përfitueset të ndihmohen për të hapur biznese të vogla me anë të të cilëve mund të gjenerojnë të ardhura për vete dhe familjen e tyre. Në kuadër të shërbimit ato mund të ndihmohen me mjete profesionale (si p.sh. mjetet e punës për të hapur një parukeri) ose me shuma parash (grante) me anë të të cilave vetë personi mund të bëjë investimet e para për një biznes. Kjo ndihmë duhet të ofrohet në bazë të profesionit që përfituesja ka marrë pas formimit profesional. Stafit specialist duhet të vlerësojë dhe monitorojë ecurinë e këtyre mikrobizneseve, të cilat rezultojnë se përmirësojnë cilësinë e jetës së ish viktimave të dhunës dhe fuqizojnë familjet e tyre. Aktualisht Bashkia Pogradec nuk e ofron këtë shërbim.

Kthimi pranë familjeve të origjinës/ jetesë e pavarur

Pas trajtimit dhe marrjes së shërbimeve përfitueset kthehen pranë familjeve të tyre ose zgjedhin jetesë të pavarur sipas kushteve dhe dëshirës. Ky shërbim është rezultat i një procesi vlerësimi të nevojave të realizuara nga punonjësit e ZBGJ dhe institucionet e MR që nga njohja me rastin dhe deri në trajtimin përfundimtar të saj. Të gjitha shërbimet e ofruara ndikojnë direkt në sigurinë dhe fuqizimin social, ekonomik dhe kulturor të përfitueseve me qëllim përfshirjen e tyre në jetën sociale. Punonjësi i ZBGJ monitoron ecurinë e përfitueses që pas marrjes së informacionit dhe marrjes së UMM/UM gjatë periudhës që kanë këtë masë. Gjithashtu i orienton për marrjen e



shërbimeve në komunitetet ku ato jetojnë, apo duke i mentorur dhe gjithashtu duke i mbështetur me shërbime, në rastet kur ato kanë nevojë.

Monitorimi afatgjatë dhe ndjekja e rastit

Monitorimi afatgjatë për përfitueset të trajtuara me shërbime nga institucionet e MR nuk ka, Bashkia Pogradec nuk e ofron këtë shërbim momentalisht. Monitorimi i të mbijrtuarave nga dhuna në familje është maksimumi për 1 vit për aq kohë sa është dhe afati i UM. Ky monitorim do duhej të vazhdonte edhe përtej këtij afati për një minimum 2-3 vjet. Menaxherët e rasteve duhet të realizojnë monitorimin nëpërmjet: thirrjeve telefonike, vizita në vendet e punës, vizitat në familje, vizitat në apartamentet me qera ku jetojnë, takime të zhvilluara në Zyrat e Këshillimit, etj. Gjatë këtyre kontakteve dhe takimeve të drejtpërdrejta me përfitueset, por edhe me familjarët e tyre, stafi duhet të interesohet për cilësinë e jetesës, problemet dhe vështirësitë me të cilat ato përballen, marrëdhëniet me familjarët, të afermit dhe komunitetin ku jetojnë, duke vlerësuar nevojat që ato kanë. Sigurisht mbi bazën e nevojave dhe problemeve, që vet përfitueset prezantojnë, institucionet duhet të marrin masa dhe të japin alternativa konkrete për zgjidhje. Po kështu, përfitueset informohen mbi shërbimet në komunitet dhe informacion mbi kontaktet respektive. Synohet forcimi i marrëdhënieve të përfitueseve me institucionet mbështetëse shtetërore dhe jo shtetërore në komunitetet ku ato jetojnë.

Nëpërmjet monitorimit afatgjatë, institucioni vlerëson nëse riintegrimi i viktimës në shoqëri është i suksesshëm, duke parë **treguesit e mëposhtëm.**

1. **Akomodim të sigurtë dhe të përballueshëm.** Akses në një vend të sigurt dhe të përballueshëm për të jetuar, i cili ofron një mjedis social të shëndetshëm, qoftë ky i ofruar nga një organizatë, institucion ose në rrugë private, në një afat kohor të gjatë.
2. **Siguri.** Siguria fizike e viktimës dhe mirëqenia, duke përfshirë ekspozimin ndaj kërcënimeve të dhunuesit ose nga persona të tjerë.
3. **Mirëqenie fizike.** Përfshin çdo zgjidhje të çështjeve mjekësore, të problemeve shëndetësore, dhe mirëqenie e përgjithshme fizike.
4. **Mirëqenie mendore.** Kjo mund të matet në mënyrë të përgjithshme me mënyrën pozitive të të menduarit, me vetëvlerësimin dhe vetëpranimin, por edhe me marrëdhëniet pozitive shoqërore.
5. **Statusi ligjor.** Statusi ligjor i viktimës është i sigurt – për shembull statusi ligjor si



- qytetar (ka qenë i regjistruar në lindje) dhe aksesit për dokumentet ligjore, ose në rastin e viktimave të huaja, pajisja me rezidencë të përkohshme ose të përhershme.
6. **Zgjidhja e çështjeve ligjore dhe ecuria e gjyqit.** Procesi gjyqësor ka mbaruar ose procedon me sukses dhe viktimat nuk është riviktimizuar.
 7. **Mjedis social i shëndetshëm (duke përfshirë anti-diskriminimin dhe anti-margjinalizimin).** Viktimat gëzojnë një mjedis social të shëndetshëm dhe pozitiv, ku jetojnë të pa diskriminuar dhe të pa marginalizuar.
 8. **Marrëdhënie sociale pozitive.** Ato reflektohen në marrëdhënie të shëndetshme me bashkëmoshatarët, familjen, bashkëshortët/partnerët intimë dhe komunitetin.
 9. **Mundësi arsimimi dhe trajnimi.** Për shembull, kualifikime arsimore (si në edukimin formal, ashtu edhe në atë informal), aftësi profesionale dhe trajnime, si edhe shprehi të tjera (për shembull shprehi jetësore).
 10. **Mundësi profesionale ose punësimi,** të cilat duhet të varen nga mosha dhe situata individuale, duke përfshirë punësimin ose aktivitete për gjenerimin e të ardhurave.
 11. **Gjendje ekonomike e kënaqshme.** Kjo mund të përkufizohet për shembull si aftësi për të fituar para, për të mbështetur familjen, për të plotësuar nevojat jetësore etj.

Përafrime të shkurtër të situatës në Bashkinë Pogradec.

Hapat e planit të riintegrit	Detaje rreth procesit	Personi & Institucioni përgjegjës për ndjekjen	Partnerët vendore të nevojshëm për zbatim	Burimet njerëzore të nevojshme	Burimet Financiare të nevojshme
Referimi	Identifikimi i Viktimëve dhe Dhunës	Policia Kordinatori i Dhunës në Bashki Shoqata UG Bashkia/ NJMF/PMF SHSSH Rajonal Persona Kontakti Door to Door UG dhe Administratorët e NJAD Administratorët e Lagjeve	Policia Bashkia PMF Koordinatori i Dhunës SHSSH Rajonal Institucionet e Shëndetit Institucionet Arsimore (Shkollat) Inspektorati i Punës OJF që ofrojnë shërbime	Janë të përcaktuar në organikat e institucioneve Për rastet e OJF punonjës socialë/psikologë	Janë të përcaktuar në buxhetin e çdo institucioni Door to door 7 persona X 10000 lek/vit
Vlerësimi i nevojave	Vlerësimi i nevojave për akomodim, siguri, nevoja shëndetësore, nevoja	Koordinatori i Dhunës (viktimat dhe dhunës) NJMF (viktimat)	Bashkia (Koordinatori i Dhunës) (PMF) Mekanizmi i	Koordinatori i Dhunës PMF Specialist i SHSSH Rajonal	Për institucionet shtetërore, janë të përcaktuara në organikat e



	psikologjike, nevoja ligjore, nevoja arsimore, nevoja profesionale	e mitura) SHSSH (viktimat madhore) Menaxher rasti (per OJF)	Referimit (Tryeza Teknike) SHSSH OJF Lokale	Menaxher rasti (OJF)	punës
Hartimi dhe zbatimi i planit të ndihmës	Takim i Grupeve Teknike Ndersektorial e Takim i Mekanizmit të Koordinuar të Dhunës Takim i Tryezës Teknike Çdo plan ka të përshkruar: objektivat, aktivitetin për çdo objektiv, personat përgjegjës, afatet kohore, buxhetin krahas aktiviteteve.	Koordinatori i Dhunës (viktimat e dhunës) NJMF (viktimat e mitura) SHSSH (viktimat madhore) Menaxher rasti (per OJF)	Policia (mbrojtjen) Prokuroria (mbrojtjen) Zyra Avokatore (mbulimi i çështjeve ligjore) PMF (per hartimin dhe monitorimin e Planit, marrëdhëniet me familjet) Koordinatori i Dhunës (për hartimin dhe monitorimin e planit, marrëdhëniet me familjet) SHSSH (për vendosjen e	Për institucionet shtetërore, janë të përcaktuar në organikat e punës Duhet shtuar psikologë në organikën e Policisë, Bashkisë dhe SHSSH Duhet përfshirë avokatë Për OJF (punonjës social, psikolog, jurist)	

			personit pranë institucioneve rezidenciale ose komunitare, ose për lehtësimin e Ndihmës Ekonomike, KEMP, etj) Institucionet e Shëndetit (nevojat shëndetësore) Institucionet arsimore (nevojat për mjete dhe lehtësim të procesit mësimor) Inspektorati i punës (kontrollin për punësimin) Zyrat e formimit profesional (nevojat për trajnime profesionale)		
--	--	--	--	--	--



			Zyrat e Punësimit (referimin për punësim)		
Strehimi dhe siguria –në Qendrën e Emergjencës dhe strehëza	Pritja dhe Vendosja e Viktimave të Dhunës në Qendrën e Emergjencës	Policia SHSSH NJMF/PMF QKVDHF Linja e kështillimit për gra dhe vajza 116 117 Qendra Emergjence Lokale	Policia SHSSH Rajonal NJMF/PMF Strehëza për trajtimin e Viktimave të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare (Qendra Kombëtare e Rehabilitimit të Viktimave të Dhunës; Strehëza për gratë dhe vajzat, Tiranë; Qendrat e Grave që ofrojnë strehim emergjent; Gruaja tek Gruaja Shkodër;	Inspektorë të Policisë Inspektorë të SHSSH Rajonale Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve Koordinatori i strehëzës/ menaxheri i riintegritet Menaxherët e rasteve në strehëz	Të gjitha strehëzat kanë të përcaktuar në organikat e tyre staf të përcaktuar për të punuar direkt në strehëz Kosto e Qendrës së Emergjencës për: Ushqim 2000 lek/dita për person Mirembajtje 1000 lek/dita për person Energji, Ujë 100 lek/dita për person Veshmbathje shpenzime të tjera 1000



			Forumi i Gruas Elbasan; Unë Gruaja, Pogradec, etj)		lek/dita për person Shpenzime totale 5000 lek/dita për person.
Asistencë dhe këshillim psikologjik	Këshillim individual Fokus grupe Terapi Ndihmë për fëmijët në Polici, Prokurori, Gjykatë, Përmbarrim, etj	Psikolog (Polici) Psikolog (Bashki) Psikologët e shkollave Psikolog (UG)	Urdhri i Psikologut OJF Bashkia Zyra Vendore Arsimore Pogradec	Psikolog në polici Psikolog në Bashki (pranë Drejtorisë së Shërbimeve sociale) Psikolog pranë UG që punojnë në fushën e Dhunës me bazë gjimore.	Të vendosen psikologë në Polici ndërsa në Bashki është një Psikologe
Asistencë mjekësore	Kontroll mjekësor Referim tek specialistët e shëndetit (përfshirë spitalet) Rimbursimi i medikamenteve Kontroll	Mjekët e familjes Personeli shëndetsor Psikologët dhe punonjësit socialë të DRSHP	DRSHP Spitalet Rajonale Spitalet Psikiatrike Qendrat e Shëndetit Mendor OJF	Psikolog pranë institucioneve të shëndetit Mjekët e familjes Person koordinues i shëndetit që merret me referimin e rasteve të dhunës sipas të drejtave të siguruar me ligj	Për institucionet shtetërore, janë të përcaktuar në organikat e punës ose të shtohen Medikamente dhe analiza mjekësore emergjente



	dentar				sipas nevojës nga UG
Asistencë ligjore	Informim mbi të drejtat dhe legjislacionin Përpilimi i Urdhrave të mbrojtjes Përpilimi i padive Shoqërimi në institucionet e zbatimit të ligjit Përfaqësim në Gjykatë (çështje civile dhe penale) Ndihmë për regjistrim në gjendjen civile, përfitimin e statusit të jetimit, etj	Juristi i “ “Unë, Gruaja” Zyra e Shërbimit Ligjor Falas Pogradec Koordinatori i vendosur në Prokuroritë e Rretheve për informimin dhe mbështetjen e Viktimave Avokatë të urdhrit të Avokatit, të ofruar direkt nga Shteti	Policia Prokuroria Gjykata Urdhri i Avokatit OJF të tjera Përmbarimi	Avokatë të licencuar Avokatë të licencuar të organizatës/ave Avokatë të Klinikave Ligjore/ Zyra e Shërbimit Ligjor Falas Koordinatorët për mbështetjen e viktimave pranë Prokurorive	Zyra e ndihmës ligjore Falas, Juristja e UG Avokati i Popullit
Mbështetje arsimore	Regjistrim në shkollë (viktimat)	Specialist edukim Personi	DAR ZVA	Koordinator pranë DAR ose ZA për viktimat dhe	Janë të përcaktuara në buxhetin e cdo



	minorene, fëmijët e viktimave) Mjete mësimore përfshirë librat, fletoret, cantat dhe mjetet e nevojshme shkollore (viktimat minorene) Ndërmjetësi m për regjistrim në kopësht dhe çerdhe për fëmijët e viktimave (nevojitet pagesa e kopshtit dhe çerdhes për ushqimin e tyre)	koordinues për mbështetje e viktimave të Dhunës pranë DAR ose ZA, i cili është edhe anëtar i Tryezës Teknike Drejtuesit e shkollave	Shkollat OJF UG,Diakonia, Fundjava Ndryshe, Amarotan	fëmijët e tyre Drejtuesit e shkollave Psikologë dhe punonjës socialë të shkollave Psikologu i UG	institucioni Fonde nga donatorë të tjerë për libra dhe mjete mësimore Kopshtet dhe çerdhet të rimbursuara nga Fondi i Planit Social të Bashkisë
Mbështetje dhe këshillim në familje	Takime me familjarë Telefonata Këshillime	Menaxher i rasteve të Dhunës.	SHSSH Rajonal Bashkia	Inspektor i SHSSH Rajonal PMF	Të përcaktuar në buxhetin e insitucioneve sipas organikës dhe



	pranë familjes Mbështetje për punësim për anëtarë të familjes Ndihmë mjekësore për anëtarë të familjes	Specialist i SHSSH Rajonal Punonjës i mbrojtjes së fëmijëve për rastet e fëmijëve në familje dhe Administratorë Shoqërorë Bashkia	(Njësia për mbrojtjen e Fëmijëve Administrator ët Shoqërorë (Bashkia) Zyra e Punësimit(Zyrat e Formimit Profesional dhe të Punësimit) Mjekë të familjes	Administratorë Shoqërorë Zyra e Formimit Profesional dhe Punësimit Mjekë të familjes Menaxherë Rasti pranë Bashkisë dhe OJF-ve	përshkrimi të punës
Mbështetje për fëmijët e viktimave	Regjistrim në çerdhe, kopësht, shkollë Mjete mësimore përfshirë librat, fletoret, cantat dhe mjetet e nevojshme shkollore	NJMF/PMF (Bashki) Mjeku i Familjes Zyra Arsimoare Vendore Pogradeç Shoqata "Unë, Gruaja"	Bashkia (NJMF) Institucionet e Shëndetit Institucionet e Arsimit Zyrat e Gjendjes Civile Gjykata Prokuroria	PMF Administratorë Shoqëror Psikologë/ punonjës socialë/ mësues dhe drejtues shkollash Drejtues Kopshtesh/ Cerdhesh Mjekë të familjes Psikolog, avokat,	Të përcaktuar në buxhetin e Shtetit në organikat përkatëse të institucioneve shtetërore NJMF+PMF UG & OJF të tjera Ofrimi i asistencës

			Policia OJF UG, Diakonia, Fundjava Ndryshe, Amarotan	të UG.	ligjore dhe psikologjike falas nga UG
Trajnimi për punësim.	Cikël trajnimi për punësim (hartimi i kurrikulës, eksplorimi i tregut, plani individual i drejtimit drejt tregut të punës, etj)	Zyrat e punësimit OJF	Drejtoritë rajonale të punësimit OJF	Trajnues për punësimin (për të gjitha kategoritë në nevojë, përfshirë edhe viktimat e dhunës) OJF (Specialisti i punësimit)	Në institucionet shtetërore është e përcaktuar në organikë për nxitjen e punësimit nëpërmjet kurseve profesionale nga Zyra e Punës. Trajnime të veçanta për nxitjen e punësimit nga UG dhe OJF të ndryshme.
Formim profesional	Rregjistrimi pranë QFP,	Përgjegjësi i Qendrës së	QFP Biznese	Koordinator për referimin e rasteve	Në institucionet

dhe trajnim në punë	Bizneseve Monitorimi i formimit	Formimit profesional OJF (Specialisti i punësimit)	OJF	të dhunës QFP OJF (Specialisti i punësimit)	shtetërore është e përcaktuar në organikë, ose duhet shtuar Formim profesional falas nga shteti – fonde nga donatorë të tjerë
Shërbimi i ndihmës për punësim.	Rregjistrimi pranë DRP ose ZP, Ndërmjetësi mi me Bizneset	Përgjegjësi i DRP ose ZP OJF (Specialisti i punësimit)	DRP ose ZP Biznese OJF	Koordinator për referimin e rasteve të dhunës pranë DRP ose ZP OJF (Specialisti i punësimit)	Në institucionet shtetërore është e përcaktuar në organikë, ose duhet shtuar
Mbështetja me mikrobiznese	Grante për biznese të vogla Plan Biznesi	OJF (Specialisti i punësimit)	Donatorë OJF (Specialisti i punësimit)	Donatorë OJF (Specialisti i punësimit)	Sipas thirrjeve të hapura nga donatorë lokalë apo kombëtarë si dhe nga strukturat shtetërore.
Kthimi prane familjeve te origjines/	Vlerësimi i situatës së riskut/	Specialisti i SHSSH Rajonal	Administratorët	Specialisti i SHSSH Rajonal	Në institucionet shtetërore/

Jetese e pavarur	situatës familjare Kthimi pranë familjes së origjinës Planifikimi i akomodimit në një vend tjetër alternativ (qendër tjetër, apartament me qera)	PMF (Bashki) Koordinatori i dhunës (Bashki)	shoqërorë OJF	PMF (Bashki) Koordinatori i dhunës (Bashki) Administratorët shoqërorë OJF (Koordinatori i riintegritit/ menaxher Rasti)	është e përcaktuar në organikë, ose duhet shtuar 720000 Lek në vit për menaxhere rasti në komunitet
Strehim në apartamente me qera / Jetese gjysem e pavarur	Vendosja në Apartament e me qera/ banesa sociale Pagesa për nevojat bazë në 3 muajt e parë të jetesës në apartamente me qera	Bashkia (Banesa sociale) Bashkia (Pagesa e Bonusit të Qerasë për apartamente) OJF (Pagesa e apartamentit me qera)	Bashkia OJF Biznese	Këshilli Bashkiak Koordinatori i Dhunës PMF OJF (Koordinatori i riintegritit/ menaxheri i rastit)	Rreth 10 familje /persona në vit (7000 lek në muaj)



Monitorimi afatgjatë dhe follow up	Vlerësime çdo 3 ose 6 muaj pas përfundimit të planit fillestar të ndihmës Takime, intervista	Koordinatori i dhunës (rastet e dhunës) PMF (për rastet e viktimave të mitura dhe fëmijëve në rrezik) SHSSH rajonal (për viktimat e rritura të trafikimit) OJF (menaxheri i rastit)	Bashkia SHSSH OJF	Koordinatori i dhunës (rastet e dhunës) PMF (për rastet e viktimave të mitura dhe fëmijëve në rrezik) SHSSH rajonal (për viktimat e rritura të trafikimit) OJF (menaxheri i rastit)	Në institucionet shtetërore është e përcaktuar në organikë, ose duhet shtuar 720000 Lek në vit për menaxhere rasti në komunitet
---	--	---	-------------------	---	---

Tregues të suksesit dhe praktika të mira

Koordinim dhe bashkëpunim me aktorë të tjerë

Me qëllim riintegrimin dhe fuqizimin e ish viktimave, i rëndësishëm është koordinimi me të gjithë aktorët kundër dhunës për referimin, asistencën, mbrojtjen dhe riintegrimin. “Unë, Gruaja” ofron gjithashtu ekspertizën e saj për organizata dhe institucione të tjera shtetërore që punojnë kundër dhunës.

Prej krijimit të saj në vitin 2003 , “Unë, Gruaja” ka patur partner kryesor në zbatimin dhe realizmin me sukses të projekteve të saj, institucionet shtetërore qendrore dhe ato vendore, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, komunitetin me të cilin punon, etj. Bashkëpunimi me



këto institucione i kanë dhënë mundësinë UG të përcaktojë objektiva të qarta, të cilat kanë në qender të tyre realizimin me sukses të misionit të saj.

Bashkëpunim të ngushtë “Unë, Gruaja” ka patur dhe do të ketë me institucione qendrore si dhe me gjithë strukturat vendore në Qarqe e Bashki. Po kështu, bashkëpunohet me Organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, rrjete dhe koalicione në vend dhe në Rajon dhe në mënyrë të veçantë Rrjetin e Fuqizimit të Grave në Shqipëri (AWEN).

Si rezultat i këtij bashkëpunimi kontribuohet drejtpërsëdrejti në marrjen e një sërë nismash të rëndësishme, si edhe në dhënie e asistencës në fushën e legjislacionit shqiptar, të shërbimeve sociale, të aftësisimit profesional të strukturave shtetërore, hartimin e Strategjive dhe Planeve kundër Dhunës në Familje etj.

Marrëveshjet e bashkëpunimit

Bashkëpunimi që Shoqata “Unë, Gruaja” ka vendosur me aktorë të tjerë qendrorë dhe lokalë në implementimin e programit të riintegritetit është formalizuar nëpërmjet vendosjes së marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit, të cilat janë të rinovueshme dhe të zbatueshme me qëllim ofrimin e shërbimit cilësor për viktimat dhe fëmijëve të tyre, si dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Këto marrëveshje hartohen dhe zbatohen në përputhje dhe zbatim të legjislacionit Shqiptar, Ato kanë në themel ruajtjen e konfidencialitetit dhe respektimin e të drejtave të viktimave. Marrëveshjet e bashkëpunimit mbështeten në parimin e bashkëpunimit dhe plotësimin e shërbimeve, si edhe kanë shtrirje më të gjerë sesa thjesht ofrimi i shërbimeve. Ato hartohen edhe në drejtim të parandalimit, si edhe ngritjes së kapaciteteve të aktorëve vendorë dhe OJF.

Lobimi dhe advokimi për përmirësimin dhe zbatimin politikave lokale

1. Përfshirja në Skemën e Strehimit Social.

Në kuadër të Planit Social në Bashkinë Pogradec, advokohet për përfshirjen e Viktimave të Dhunës në Familje në skemën e përfitimit të Bonusit të Qerasë për apartamentet, ose të Strehimit Social, në zbatim të ligjit 22/2018 datë 03.05.2018 “Për strehimin social”. Përfitueset e

shërbimeve, informohen, mentorohen dhe ndihmohen për sigurimin e dokumentacionit përkatës për përfitim të strehimit. Duhet thënë se pavarësisht ligjit dhe bashkëpunimit me Bashkinë Pogradec ka një numër të ulët të viktimave, të cilat përfitojnë strehim apo bonus të qerasë, pasi buxhetimi i këtij shërbimi nga ana e Bashkisë është mjaft i kufizuar dhe me kërkesa dokumentacioni, për të cilat viktimat kanë vështirësi në sigurimin e tij.

Në ligjin 22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social", janë përcaktuar kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojë çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë për të përfituar nga ky ligj.

Gjithashtu në këtë ligj, por dhe pranë Bashkisë mund të gjeni më shumë informacion mbi llojet e programeve sociale të strehimit. Në programet e strehimit social përfshihen:

1. programi i banesave sociale me qera, BSQ
2. programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri
3. programi i banesave me kosto të ulët, BKU
4. programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi
5. programi për krijimin e banesave të përkohshme
6. programi i banesave të specializuara

Kushtet për fitimin e statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit

1. Statusin e përfituesit nga programet sociale sipas këtij ligji e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:
2. Nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi
3. Kanë mbetur të pastreha, si rezultat:
 - a. i fatkeqësive natyrore
 - b. i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë
 - c. i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve
 - d. nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë.



e. familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembje, ose një banesë që i nënështrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj

4. Përfitojnë nga programet e strehimit social të këtij ligji edhe shtetas të huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri dhe që kanë përfituar nga organet kompetente statusin si "punëtor emigrant", ose "azilkërkues".
5. Parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen vetëm për ato individë / familje që kanë të ardhura të pamjaftueshme, ose që nuk kanë fare të ardhura, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
6. Të drejtën për të përfituar nga programi i banesave sociale e kanë edhe të miturit nën moshën 18 vjeç, pas lirimit ose përfundimit të programit të masës alternative të shmangies, në rastin kur bazuar në një vendim gjyqësor ose një akt administrative, mbeten të pastrehë, për arsye se nuk duhet të jetojnë me prindërit, kujdestarin ligjor ose me familjet e tyre.

- **Aleanca e Zgjeruar e Grave Këshilltare Bashkia Pogradec** është një grup informal dhe vullnetar i grave/vajzave këshilltare, në Këshillin Bashkiak Pogradec & grave e vajzave që janë aktive në partitë që janë jashtë Këshillit, të shquara në shoqërinë civile, biznes, etj. AZGKB Pogradec u themelua në Tetor 2020.

AZGKB Pogradec ka si qëllim:

- Fuqizimin e grave dhe vajzave këshilltare bashkiake dhe ndikimin e tyre në përmirësimin dhe hartimin e politikave lokale të favorshme për komunitetin, gratë dhe grupet e tjera të pafavorizuara në Bashkinë Pogradec.
- Të advokojë zgjidhjen e problemeve të grave e vajzave, si dhe fuqizimin dhe avancimin politik, ekonomik dhe social të grave që jetojnë në territorin administrativ të Bashkisë Pogradec
- Monitorim i zbatueshmërisë së ligjshmërisë për barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale në nivel lokal me fokus në shërbimet sociale.
- Akses dhe shërbime të shtuara lokale .
- Ngritja e Njësive të Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave në Bashki.



- Nxjtja dhe ofrimi në bashkëpunim me OJF-të e rrethit tonë, Zyrën Vendore të Punësimit i kurseve të trajnimit profesional për gratë dhe vajzat e dhunuara, etj.

Kjo Aleancë ka shprehur gadishmërinë për bashkëpunimin me UG në kuadër të përmirësimit dhe rritjes së cilësisë së shërbimeve për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje. Gjithashtu me AZGKB janë realizuar disa takime dhe tryeza diskutimi në të cilat është vendosur plani i punës dhe pikat ku duhet të përqëndrohem me qëllim arritjen e objektivave dhe kërkesave të viktimave të dhunës në afat sa më të shkurtër.

Identifikimi në terren

Identifikimin e rasteve të dhunës në terren dhe sidomos në zonat rurale e Nj. Administrative krahas institucioneve që kanë detyrimin të referojnë në një pjesë të madhe e bëjnë dhe grupi i **personave të kontaktit “Door to door”** pranë Shoqatës “Unë, Gruaja”. Pasi identifikojnë rastet i referojnë ato pranë UG dhe institucioneve të ndryshme për të marrë shërbime nga: Policia, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Drejtoria e Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale në Bashki, Koordinatorin e Dhunës, Shërbimin Social Shtetëror, etj. Grupi “Door to door” janë burim i rëndësishëm në identifikimin dhe referimit të rasteve të viktimave të mundshme të dhunës pranë UG dhe jo vetëm.

Rol të rëndësishëm në identifikimin e rasteve në terren e më pas referimin e tyre sa i përket zonës së qytetit janë **Koordinatorët e Lagjeve**. Ata njohin nga afër komunitetin, dinë problematikat e tyre dhe bashkëpunimi me këta të fundit lehtëson marrjen e shërbimeve që UG dhe Bashkia ofrojnë për komunitetin.

Ngritja e **Ekipeve Teknike Ndërdisciplinare (ETN) model në çdo Njësi Administrative** iniciuar nga “Unë, Gruaja” e mbështetur nga Bashkia Pogradec, është një mekanizëm tjetër, i cili shërben në identifikimin dhe referimin, jo vetëm të rasteve të dhunës, por dhe të shqetësimeve dhe problemeve që komuniteti ka në 7 Njësitë Administrative të Bashkisë Pogradec. Ky funksion i plotësuar dhe nga Roli i Administratorëve Shoqërorë në Njësi e bën më efektive punën e tyre.

